


TIRANË 2026

PLANI STRATEGJIK

2026-2031

I UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS



UNIVERSITETI
POLITEKNIK
I TIRANES

Sheshi "Nënë Tereza", 4
Tiranë ALBANIA
Tel: +355 4 2227914
Web: upt.edu.al

MIRATOHET

Kryetari i Senatit Akademik

PROF. DR. AKLI FUNDO



PLANI

STRATEGJIK

2026-2031

I UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

I. VIZIONI DHE MISIONI I UPT

Vizioni

Universiteti Politeknik i Tiranës synon të jetë institucion publik lider në arsimin inxhinierik dhe kërkimin shkencor, i njohur për cilësi, integritet akademik dhe inovacion. Përmes arsimit gjithëpërfshirës, kërkimit të avancuar dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, UPT kontribuon në zhvillimin ekonomik, teknologjik, industrial, shoqëror dhe mjedisor të vendit, duke përgatitur profesionistë dhe studiues të aftë për sfidat e së ardhmes dhe transformimin teknologjik. Integrimi në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë dhe praktikat ndërkombëtare forcon ndikimin rajonal dhe global, duke e bërë universitetin një pikë referimi për lidërsip dhe ekspertizë.

Misioni

Universiteti Politeknik i Tiranës, i themeluar në 1951, në përputhje me zhvillimin historik të arsimit të lartë në Shqipëri, synon të formojë inxhinierë, arkitektë dhe specialistë të lartë në fushat inxhinierike dhe teknologjike, të zhvillojë kërkimin shkencor sipas standardeve ndërkombëtare dhe të kontribuojë në modernizimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Gjatë historisë, UPT ka formuar shumicën e specialistëve që kanë projektuar dhe realizuar veprat kryesore inxhinierike, infrastrukturën dhe zhvillimin industrial të Shqipërisë. Si institucioni kryesor publik me profil të plotë inxhinierik, universiteti mban një rol udhëheqës në zhvillimin e kapaciteteve kombëtare dhe synon të konsolidohet si qendër rajonale e njohur për formimin inxhinierik, kërkimin e aplikuar dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, duke integruar ekspertizën në infrastrukturë strategjike, burime natyrore dhe transformim teknologjik, në përputhje me prioritetet kombëtare dhe hapësirën evropiane të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Në këtë kuadër, UPT synon:

- Të krijojë dhe zhvillojë dije në inxhinieri, arkitekturë dhe teknologji, duke integruar mësimdhënien me kërkimin dhe inovacionin, dhe duke formuar profesionistë me kompetenca të larta teknike, analitike dhe etike;
- Të përgatisë inxhinierë dhe studiues të aftë për të projektuar, ndërtuar dhe modernizuar infrastrukturën, industrinë, sistemet energjetike dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- Të zhvillojë kërkim shkencor konkurrues dhe transferim të teknologjisë, në bashkëpunim me institucionet publike, sektorin ekonomik dhe partnerët rajonalë e evropianë, duke forcuar rolin e tij si qendër ekspertize teknike dhe duke adresuar sfidat e së ardhmes;
- Të ofrojë arsimim gjatë gjithë jetës dhe zhvillim profesional të vazhdueshëm, duke garantuar akses të barabartë dhe përditësim të njohurive;
- Të forcojë praninë dhe ndikimin ndërkombëtar përmes integritit në rrjete akademike dhe kërkimore, pjesëmarrjes në programe evropiane dhe harmonizimit me standardet e cilësisë.

II. NDËRKOMBËTARIZIMI I UPT 2026-2031

II.1 SYNIMET E NDËRKOMBËTARIZIMIT TË UPT

Synimet e ndërkombëtarizimit janë:

1. Rritja e njohjes ndërkombëtare të titujve universitarë të lëshuar nga UPT, në të gjitha ciklet e formimit.
2. Forcimi dhe konsolidimi i bashkëpunimit të suksesshëm, afatgjatë dhe të qëndrueshëm me universitetet dhe institucionet partnere evropiane dhe më gjerë, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit, përmes konsolidimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm dhe të mëtejshëm të tyre me objektiva të reja të përbashkëta strategjike dhe inovative.
3. Zhvillimi i mëtejshëm dhe i vazhdueshëm i bashkëpunimit me interes reciprok, përmes marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit dhe partneritetit ndëruniversitar ndërkombëtar, referuar parimit themelor të UPT-së, si një universitet i hapur ndaj dijes, kërkimit shkencor, inovacionit dhe bashkëpunimit.
4. Zhvillimi i mëtejshëm i pjesëmarrjes aktive, kontributit dhe partneritetit të UPT-së në rrjetet ndërkombëtare të universiteteve të rajonit, evropiane dhe më gjerë (UNICA, Magna CARTA, AUF, BSUN, etj.), por edhe të pjesëmarrjes në organizma dhe rrjete të reja në interes të zhvillimit dhe promovimit të UPT-së.
5. Konsolidimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit afatgjatë dhe të qëndrueshëm, por edhe realizimi i marrëveshjeve të reja në fushën e mësimdhënies dhe të shkëmbimit të personelit akademik në të gjitha ciklet e formimit.
6. Konsolidimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit afatgjatë dhe të qëndrueshëm, por edhe realizimi i marrëveshjeve të reja në fushën e kërkimit shkencor, inovacionit dhe projekteve për të tretët.
7. Intensifikimi i shkëmbimeve ndërkombëtare të studentëve në kornizën e programeve ndërkombëtare dhe marrëveshjeve dypalëshe.

III. MENAXHIMI INSTITUCIONAL I UPT

III.1 ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM I KAPACITETEVE NJERËZORE, FINANCIARE DHE INFRASTRUKTURE

III.1.1 ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM I KAPACITETEVE NJERËZORE (ZH.Q.K.NJ.)

Për zhvillimin e qëndrueshëm të kapaciteteve njerëzore parashikohet të prioritizohen:

1. Respektimi i rregullave dhe legjislacionit në fuqi për punësimin dhe përmirësimi i politikave të rekrutimit të personelit të universitetit.
2. Rekrutimi i personelit akademik me arritje të spikatura në fushën e tij profesionale, në arenën ndërkombëtare, në veçanti për studentët shqiptarë që mbarojnë studimet jashtë vendit në IAL-të ndërkombëtare.
3. Aplikimi i një sistemi më të gjerë vlerësimi për personelin akademik, i cili duhet të lidhet me promovimin e tij.
4. Aplikimi i një politike motivimi për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ duke i inkurajuar të ndjekin kualifikime në fushën e tyre profesionale.
5. Garantimi i mundësive të barabarta për zhvillimin e karrierës së personelit akademik, ndihmësakademik dhe adminsitativ.
6. Menaxhimi në mënyrë efikase dhe organizimi i universitetit në mënyrë të tillë që studentët e të trija cikleve të studimit të kenë ndjesinë që UPT si institucion i arsimit të lartë është krijuar dhe punon për ta.

III.1.2 ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM I KAPACITETEVE FINANCIARE (ZH.Q.K.F.)

UPT synon të realizojë në këtë fushë objektivat si vijon:

1. Shtim të sasisë dhe tipologjisë së të ardhurave dytësore të UPT-së me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe rritjen e autonomisë financiare.
2. Sigurim i granteve nga buxheti i shtetit dhe organizma të tjerë shtetërorë në mbështetje të qëndrueshmërisë financiare dhe investimeve kapitale.

III.1.3 ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM I KAPACITETEVE INFRASTRUKTURE (ZH.Q.K.I.)

UPT për ZH.Q.K.I. synon :

1. Përbushje të standardeve infrastrukturore të cilësisë për institucionet e arsimit të lartë të profileve inxhinierike për sigurinë e jetës dhe shëndetit të përdoruesve, përmirësim të raportit $m^2/student$ dhe parametrave ndërtimorë të ambienteve.
2. Përmirësim dhe rinovim të vazhdueshëm të bazës materiale të ambienteve në funksion të procesit mësimor dhe atij kërkimor – shkencor, në përputhje me evoluimin e kërkesave të moduleve lëndore.
3. Zhvillim dhe përmirësim të infrastrukturës IT të institucionit.

IV. MENAXHIMI I PROCESIT TË MËSIMDHËNIES NË UPT

Universiteti Politeknik i Tiranës synon të garantojë cilësi të qëndrueshme dhe zhvillim të vazhdueshëm në procesin e mësimdhënies përmes modernizimit të metodave të edukimit, harmonizimit me standardet kombëtare dhe evropiane, orientimit drejt tregut të punës, fuqizimit të rolit të studentit dhe rritjes së ndikimit shoqëror dhe ekonomik të institucionit. Në vijim paraqiten objektivat strategjikë dhe drejtimet kryesore të veprimit për përmirësimin e mësimdhënies dhe të rezultateve të të nxënës në UPT.

IV.1. PËRMIRËSIMI I VAZHDUESHËM I CILËSISË NË PROCESIN E EDUKIMIT PËRMES STANDARDEVE TË AVANCUARA

UPT synon forcimin e kulturës së cilësisë në të gjitha njësitë akademike dhe administrative përmes zhvillimit të një sistemi të integruar të sigurimit të brendshëm të cilësisë, të bazuar në standardet evropiane të arsimit të lartë (ESG), si dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare.

UPT ndërton dhe zbaton mekanizma të qartë për:

- Monitorimin periodik të cilësisë së programeve të studimit dhe proceseve mbështetëse;
- Forcimin e mekanizmave akademikë të vendimmarrjes, të bazuar në të dhëna, transparencë dhe llogaridhënie;

- Përfshirjen aktive të studentëve në vlerësimin e cilësisë, duke krijuar mekanizma të strukturuar të feedback-ut;
- Ruajtjen dhe zhvillimin e praktikave të qëndrueshme të etikës akademike në mësimdhënie dhe vlerësim, në funksion të transparencës dhe besueshmërisë.

Qëllimi kryesor është ndërtimi i një kulture institucionale që e konsideron cilësinë si proces të vazhdueshëm zhvillimi dhe inovacioni dhe jo si aktivitete të rastësishme apo administrativ.

IV.2. ZHVILLIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MBI BAZËN E REZULTATEVE TË TË MËSUARIT DHE ME STUDENTIN NË QENDËR

UPT orienton të gjithë procesin akademik drejt një qasjeje të re pedagogjike, e cila vendos studentin në qendër dhe siguron zhvillimin e kompetencave akademike, teknike dhe të përgjithshme të kërkuara nga tregu i punës dhe nga standardet evropiane të arsimit të lartë.

Zhvillimi i programeve bazohet në gjashtë shtylla kryesore:

- Vendosja e studentit në qendër të procesit, duke integruar metoda bashkëkohore si mësimdhënia e bazuar në projekte, problemet reale të industrisë, mësimi i kombinuar (blended learning) dhe qasje të personalizuar;
- Integrimi i qasjeve inkluzive dhe mbështetja e studentëve me nevojat të veçanta për të garantuar një mësimdhënie gjithëpërfshirëse;
- Harmonizimi i programeve të studimit me rezultatet e të mësuarit, të formuluar sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe EQF, duke garantuar koherencë, qartësi dhe kompetenca të matshme;
- Përafrimi i programeve me nevojat aktuale dhe perspektive të tregut të punës, duke përfshirë bashkëpunime me industrinë në hartimin, rishikimin dhe përditësimin e kurrikulave;
- Integrimi i projekteve kërkimore dhe aktivitetit shkencor të studentëve në procesin mësimor për të rritur aftësitë praktike, inovative dhe ndikimin shoqëror;
- Integrimi i Taksonomisë Bloom dhe Taksonomisë Solo në hartimin e instrumenteve të vlerësimit, duke siguruar që provimet, detyrat dhe projektet të matin nivele të ndryshme të të menduarit dhe të vlerësojnë cilësinë e të nxënësve në mënyrë objektive dhe të standardizuar.

Ky proces siguron që diplomantët e UPT të zotërojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për punësim, inovacion, zhvillim profesional dhe kontribut të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe teknologjik të vendit.

IV.3. VLERËSIMI PERIODIK I PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE AKREDITIMI I TYRE

UPT synon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit përmes:

- Vlerësimeve të rregullta kurrikulare, me cikël rishikimi 3–5 vjeçar;
- Akreditimit institucional dhe të programeve, sipas standardeve shtetërore dhe duke synuar edhe akreditime ndërkombëtare;
- Përfshirjes së aktorëve të jashtëm dhe të brendshëm në vlerësimet periodike (studentë, alumni, punëdhënës, ekspertë të industrisë).

Qëllimi është rritja e konkurrueshmërisë së diplomave të UPT në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian dhe përforcimi i rolit të universitetit si aktor i rëndësishëm ekonomik dhe shoqëror.

IV.4. RRRITJA E CILËSISË DHE DIVERSIFIKIMI I PRAKTIKAVE PROFESIONALE

UPT angazhohet në ofrimin e praktikave profesionale efektive dhe të strukturuar për studentët, duke synuar zhvillimin e aftësive praktike dhe të kompetencave profesionale të kërkuara nga tregu.

Institucionit synon:

- Zgjerimin e partneriteteve me bizneset, industrinë, institucionet publike dhe organizatat jofitimprurëse;
- Standardizimin e proceseve dhe programeve të praktikave (qëllimet, mentorimi, vlerësimi dhe pajisja e studentit me referencë profesionale);
- Mbështetjen e nismave të inovacionit, sipërmarrjes së studentëve dhe start-up-eve.

Diversifikimi i formave të praktikave kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e shkallës së punësimit të studentëve.

IV.5. ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS DIGJITALE NË FUNKSION TË EDUKIMIT DHE PËR ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË STAFIT

UPT synon ndërtimin e një ekosistemi të integruar dhe modern digjital që mbështet procesin akademik, menaxhimin institucional dhe zhvillimin profesional të personelit.

Prioritetet përfshijnë:

- Adoptimin e platformave të avancuara të mësimdhënies dhe menaxhimit të proceseve akademike;
- Zhvillimin e laboratorëve virtualë dhe mjeteve digjitale që lehtësojnë qasje inovative në mësimdhënie;
- Krijimin e mundësive të vazhdueshme për trajnim digjital dhe teknologjik për stafin akademik;
- Integrimin e software-ve profesionale që rrisin kompetencat teknike të studentëve dhe stafit.

UPT synon të jetë një institucion lider në përdorimin e teknologjisë në proceset akademike dhe administrative.

IV.6. ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM I CILËSISË SË PRANIMEVE NË TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT

UPT forcon cilësinë e pranimeve përmes strategjive të targetuara për promovimin e programeve dhe të vlerave të institucionit, duke përfshirë:

- Organizimin periodik të Ditëve të Hapura, aktiviteteve informuese dhe orientuese për maturantët;
- Hartimin e politikave të pranimi dhe konkurseve të pranimi të bazuara në kritere të qarta meritokracie dhe përshtatjeje me profilet e programeve;
- Përdorimin e mjeteve bashkëkohore të komunikimit dhe marketingut akademik për të tërhequr studentë cilësorë;
- Rritjen e pranimeve nga rajoni dhe jashtë vendit, duke zgjeruar impaktin;
- Hapjen e programeve të studimit në gjuhë të huaj dhe programeve të përbashkëta me universitetet e huaja, me qëllim nxitjen e ndërkombëtarizmit të studentëve dhe stafit.

Këto nisma sigurojnë tërheqjen e studentëve me potencial të lartë akademik dhe profesional dhe forcojnë pozicionin e UPT si institucion me ndikim shoqëror dhe ekonomik.

IV.7. FUQIZIMI I NISMAVE MBËSHTETËSE PËR SUKSESIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E TË DIPLOMUARVE

UPT angazhohet të mbështesë studentët dhe të diplomuarit në tranzicionin e tyre drejt tregut të punës përmes një qasjeje të koordinuar dhe pro-aktive.

Prioritetet përfshijnë:

- Monitorimin sistematik të tregut të punës dhe analizën e tendencave të zhvillimit ekonomik;
- Ofrimin e moduleve të dedikuara për zhvillimin e aftësive profesionale, komunikimit, sipërmarrjes dhe kompetencave digjitale;
- Mbështetjen e studentëve përmes ofrimit të lëndëve ekstrakurrikulare, duke rritur konkurrueshmërinë e tyre;
- Organizimin e panairove të punës, forumeve të karrierës dhe aktiviteteve të networking mes studentëve, alumni dhe punëdhënësve;
- Mbështetje e studentëve përmes këshillimit akademik në çdo program studimi.

Nëpërmjet këtyre iniciativave, UPT synon të rrisë përqindjen e punësimit të të diplomuarve në specialitetin e tyre, si dhe të forcojë rolin e tij si katalizator për zhvillimin ekonomik dhe teknologjik të vendit.

V. MENAXHIMI I KËRKIMIT SHKENCOR NË UPT

V.1 ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE

- Rritja e numrit të kërkuesve të rinj (studentë të ciklit të II/III dhe postdoktorantë) dhe angazhimi i tyre në projekte kërkimore.
- Ngritja e një sistemi mentorimi për kërkuesit e rinj.
- Trajnime periodike në metodologji kërkimore dhe etikë shkencore.

- Zhvillimi i kapaciteteve kërkimore shkencore të personelit akademik.
- Ngritja/forcimi i një sistemi vlerësimi të performancës kërkimore të personelit akademik.

V.2 MODERNIZIMI I INFRASTRUKTURËS KËRKIMORE

- Modernizimi i laboratorëve ekzistues apo/dhe ngritja e laboratorëve të rinj tematikë sipas nevojave të zhvillimit të vendit.
- Digjitalizimi i bibliotekave shkencore si dhe sigurimi i aksesit në databaza shkencore ndërkombëtare në të gjithë fushat inxhinierike që mbulon UPT.
- Zhvillimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit për mbështetje të aktiviteteve të kërkimit shkencor.
- Akreditimi dhe certifikimi i laboratorëve të kërkimit shkencor.

V.3 RITJA E CILËSISË DHE PRODUKTIVITETIT TË KËRKIMIT SHKENCOR

- Publikime në revista shkencore me faktor ndikimi apo metrika të ngjashme të vlerësimit të kërkimit shkencor.
- Përmirësimi i cilësisë së projekteve kërkimore.
- Mbështetja e projekteve pilot dhe iniciativave inovative.
- Rritja e pjesëmarrjes aktive në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Përfshirja aktive e studentëve në kërkim shkencor.
- Stimulimi financiar për performancë kërkimore.
- Rritja e ofertës akademike me studime pasuniversitare të edukimit në vazhdim.
- Rritja e ofertës akademike me programe të ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë” duke iu përgjigjur zhvillimeve aktuale teknologjike.

V.4 PËRHAPJA E REZULTATEVE TË KËRKIMIT SHKENCOR BAZË DHE TË ZBATUAR QË ZHVILLOHET NË UPT

- Menaxhimi i marrjes së patentave dhe pronësisë intelektuale dhe regjistrimi i tyre.
- Promovimi dhe mbështetja e *start-up*-eve apo edhe *spin-off* akademike në fushën e ekspertizës.
- Rritja e bashkëpunimeve me industrinë.
- Pjesëmarrje më e gjerë në ekspertiza e konsulencë, duke i konsideruar si elementë jo vetëm të afirmimit profesional e shkencor.
- Organizimi i konferencave shkencore periodike.
- Promovimi i Buletinit të Shkencave Teknike në UPT.

V.5 DIGJITALIZIMI I MENAXHIMIT TË KËRKIMIT SHKENCOR

- Menaxhimi elektronik i projekteve dhe arkivës së kërkimit shkencor.
- Krijimi dhe azhurnimi i bazës së të dhënave të kërkimit shkencor ACRIS¹ në nivel kombëtar.
- Inventarizimi i kapaciteteve laboratorike për kërkimin shkencor.
- Krijimi dhe azhurnimi i fushave specifike të kompetencës në kërkimin shkencor dhe aftësive si në burime njerëzore ashtu edhe infrastrukture.
- Integrimi i UPT në platformat evropiane të kërkimit shkencor.

V.6 NDËRKOMBËTARIZIMI I KËRKIMIT SHKENCOR

- Rritja e pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare.
- Zgjerimi i rrjetit të partnerëve akademikë ndërkombëtarë.
- Zhvillimi i programeve të përbashkëta doktorale.
- Rritja e bashkëpunimit me staf akademik dhe kërkimor si nga diaspora ashtu edhe nga institucionet partnere.
- Publikime të përbashkëta me partnerë ndërkombëtarë qoftë nga diaspora akademike e qoftë me institucionet partnere.
- Rritja e prezencës së UPT në rrjetet evropiane të kërkimit.

V.7 ZHVILLIMI I FUSHAVE PRIORITARE TË KËRKIMIT SHKENCOR

- Forcimi i rolit të Institutit të Gjeoshkencave si njësi kryesore kërkimore e ekselencës në fushat përkatëse të ekspertizës dhe rolit të saj në jetën e vendit.
- Forcimi dhe modernizimi i sistemit kombëtar të monitorimit dhe menaxhimit të të dhënave për aktivitetin sizmik, gjeologjik dhe hidro-meteorologjik në rang kombëtar.
- Rritja e rolit shkencor në përputhje me parametrat e shkencës së hapur.
- Forcimi i rolit të UPT në kërkimin shkencor, transferimin e teknologjisë dhe në digjitalizimin e ekonomisë.
- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, sektorit të biznesit dhe shoqërisë civile nëpërmjet zgjerimit të kërkimit dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta (Quadruple Helix Model).

¹ ACRIS - EN: *Albanian Current Research Information System*; AL: Sistemi Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor

VI. MENAXHIMI I JETËS STUDENTORE NË UPT

VI.1. PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË JETËS STUDENTORE DUKE SYNUAR RITJEN E CILËSISË SË SHËRBIMEVE, SI DËHE ZBATIMIN E NJË POLITIKE GJITHPËRFSHIRËSE, SI NË VENDIMMARRJE ASHTU DHE NË ZHVILLIMIN SHOQËROR PËR STUDENTËT.

VI.1.1. Përmirësimi dhe rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj studentëve, duke krijuar një kulturë shërbimi cilësor bashkëkohor, që synon:

- Rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj studentëve, nëpërmjet informimit, këshillimit, mbështetjes dhe orientimit të tyre.
- Mbështetjen e studentëve para, gjatë dhe pas studimeve të tyre në UPT dhe këshillimit të tyre nëpërmjet aktiviteteve informuese, si Gjimnaz Tour, Këshillimi përpara regjistrimit, Ditët e Hapura, Panairi i Punës etj.
- Përmirësimin e infrastrukturës në shërbim të studentëve, të kushteve të mësimit dhe të punës. Krijimin e hapësirave për studentët, për ekspozimin dhe promovimin e ideve të reja.
- Rritjen e kujdesit shëndetësor ndaj studentëve, mbështetjes psikologjike dhe kujdesit ndaj shëndetit mendor të studentëve.
- Funksionimit dhe përdorimit të Kartës së Studentit.

VI.1.2 Përmirësimi dhe zbatimi i një politikë gjithëpërfshirëse, si në vendim marrje ashtu edhe në zhvillimin e veprimtarive shoqërore nëpërmjet:

- Përfshirjes dhe pjesëmarrjes aktive të studentëve në vendim marrje.
- Mbështetjes së elitës studentore, evidentimit dhe aktivizimit të saj në projekte mësimore dhe shkencore.
- Inkurajimit të Projekteve Shkencore-Studentore, duke harmonizuar jetën studentore me kërkimin, duke krijuar një kulturë ku studentët nuk janë thjesht përfitues pasivë, por kontribues aktivë në veprimtarinë shkencore të fakultetit.

VI.1.3 UPT mbështet veprimtarinë e Këshillave Studentore, fokusuar në objektivin parësor atë të përmirësimit të cilësisë në UPT.

Për plotësimin e këtij objekti do të synohet:

- Riorganizimi i Këshillave Studentore, për pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UPT-së, në strukturat mësimore kërkimore dhe ato të shërbimeve.

VI.1.4 Përmirësimi i politikës gjithëpërfshirëse të zhvillimit shoqëror, për studentët.

UPT është i angazhuar për përmirësimin dhe zbatimin e një politike gjithëpërfshirëse të zhvillimit shoqëror për studentët, e cila synon në rritjen e veprimtarive shoqërore të studentëve jashtë auditorëve, duke ndikuar në përmirësimin e cilësisë të jetës universitare.

- Rritja e veprimtarive sociale, jashtë auditorëve të studentëve, duke përmirësuar cilësinë e jetës universitare.
- Krijimi i hapësirave për studentët, për të punuar në mënyrë të pavarur jashtë orëve të mësimin dhe për të marrë shërbime të ndryshme.
- Organizimi i Klubeve Studentore, si një strukturë shumë e rëndësishme që plotëson në vijimësi formimin e studentëve dhe i jep larmi jetës studentore.
- Mbështetja e studentëve, kryesisht të vitit të parë, nga studentët ekselentë.
- Rritja e aktiviteteve kulturore dhe sportive.

VI.2. PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT NË NIVEL INSTITUCIONAL

UPT angazhohet për përmirësimin e cilësisë së sistemit të menaxhimit të informacionit në nivel institucional, duke synuar paraqitje të plotë, të qartë, të saktë dhe të përditësuar të informacionit për studentët, që lidhet me veprimtarinë e UPT-së, veçanërisht me procesin mësimor.

- Publikimi i të gjitha informacioneve dhe njoftimeve, në kohë reale, në gjuhën shqip dhe anglisht.
- Paraqitja e plotë, e saktë dhe e përditësuar e informacionit për studentët, veçanërisht për procesin mësimor.
- Krijimi i mundësive për këshillim të personalizuar për studentët, bazuar në analizën e të dhënave të tregut të punës.
- Ngritja dhe funksionimi i një sistemi të unifikuar dhe modern të informacionit. Ndërtimi i aplikacionit MyUPT.

VI.3. MENAXHIMI I CILËSISË SË JETËS STUDENTORE TË STUDENTËVE TË HUAJ, TË CILËT MARRIN PJESË NË PROCESIN MËSIMOR TË UPT-SË, NË KUADËR TË PROGRAMEVE DHE MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE.

- Krijimi i mundësive për studentët e huaj, për t'u përfshirë në aktivitete kërkimore shkencore, sociale, kulturore dhe sportive.
- Përfshirja e studentëve të huaj në Klubet Studentore të UPT, si dhe në struktura të organizuara për studentët e huaj në nivel kombëtar.
- Krijimi i mundësive për futjen në programin mësimor të studentëve të huaj edhe të mësimit të gjuhës shqip.
- Mbështetja e studentëve të huaj nga studentët ekselentë dhe nga studentët që kanë kryer mobilitete në universitete të huaja.
- Pajisja e studentëve të huaj me kartën e studentit.

VI.4. ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI I UPT – ALUMNI

- Krijimi i një database me gjeneratat e studentëve të UPT, të cilët kanë histori suksesi dhe arritjesh në vendin tonë.
- Nxitja e frymës së besnikërisë dhe bashkëpunimit midis UPT dhe ish-studentëve të tij, me synim promovimin e interesave të Alumnit dhe universitetit, gjenerimi i ideve, programeve dhe projekteve të reja, bashkëpunimi me industrinë dhe biznesin, si dhe sigurimi i tregjeve të sigurta të punës për studentët.
- Gjurmimi dhe vlerësimi i ish-studentëve të diplomuar pranë UPT – së dhe promovimi i arritjeve të tyre, jo vetëm si shembuj të mirë, por edhe si mundësi mbështetjeje për studentët e UPT-së.
- Integrimi i ish të diplomuarve, bazuar në të dhëna (data-driven).